



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 208 / 1, Datë 12.01.17

**“PËR HEQJEN E LEJES SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË
NOTERIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 6, gërma ë) të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për Noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ SE:

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8678, datë 14.05. 2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, Ministria e Drejtësisë verifikoi veprimtarinë noteriale të noteres Bojana Hajdini. Nga verifikimi i ekstraktit historik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, subjekti Bojana Hajdini me numër Nuis L31976014BH, fusha e veprimtarisë notere, rezulton me status “Pezulluar”, që prej datës 16.12.2015. Gjithashtu nga verifikimi në Regjistrin Noterial Shqiptar rezulton se notere e Dhomës së Noterisë Tiranë Bojana Hajdini nuk e ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohore mbi 6 muaj.

Ligji nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, përcakton se; *Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë kur:*

ç) bëhet i paaftë për të ushtruar veprimtarinë për shkak sëmundjeje për një kohë më të gjatë se 6 muaj gjatë një viti;

ë) nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohe deri në 30 ditë rresht pa njoftuar me shkrim Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë;

Pranë Regjistrin të Përgjithshëm të Noterëve, në Ministri të Drejtësisë, nuk rezulton se nga notere Bojana Hajdini të ketë njoftim me shkrim mbi arsyet e mos ushtrimit të veprimtarisë noteriale për një periudhë kohe mbi 30 ditë rresht.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 6, gërmave ç) dhe ë), të ligjit nr. 7829, datë 1.06.1994, "Për Noterinë", i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit, znj. Bojana Hajdini, anëtare e Dhomës së Noterisë Tiranë, për shkak të mos ushtrimit të veprimtarisë noteriale për një periudhë kohe deri në 30 ditë rresht pa njoftuar me shkrim Dhomën Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Z. Arlind Arapi, Përgjegjës Sektori, në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
 - b) Z. Erjon Ndreca, Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
 - c) Z. Ermal Jahaj, Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
 - d) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.
 - e) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Tiranë.
3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë, Tiranë. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 45 ditor, një notere të Dhomës së Noterisë Tiranë.
4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Bojana Hajdini nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.
5. Të njoftohet menjëherë mbi urdhërin Dhoma Kombëtare e Noterëve, e cila të bëjë me dije institucionet e linjës.
6. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në regjistrin e noterëve në Ministrinë e Drejtësisë.
7. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

YLLI MANJANI

Miratoi: Bledar Kabashi, Drejtor Inspektimit
Punoi: Arlind Arapi Përgjegjës Sektori
Kopje: 2; dt. 23.12.2016